

NEWSLETTER

Janar- Mars 2025



FJALA E REKTORES

Viti 2025 është një moment historik për Tirana Business University. Me krenari, shënojmë 15-vjetorin e themelimit të institucionit tonë, një rrugëtim i mbushur me sfida, por mbi të gjitha me suksese dhe kontribute domethënëse në arsimin e lartë dhe ekonominë shqiptare.

Programet tona akademike janë të orientuara drejt tregut, duke përgatitur studentët me aftësi konkrete për sfidat profesionale. Kemi intensifikuar bashkëpunimet me bizneset shqiptare për të zgjeruar mundësitë e intershipeve. Po investojmë në zhvillimin e një komuniteti të fortë akademik, ku studentët, pedagogët dhe partnerët ndërveprojnë në një bashkëpunim dinamik.

Ky përkushtim reflektohet në rritjen e rezervimeve të hershme për vitin akademik 2025. Në këtë vit të rëndësishëm, ftojmë të gjithë ata që duan të bëhen pjesë e një institucioni që promovon ekselencën dhe inovacionin, të bashkohen me ne. Investimi në edukim është investimi më i mirë për të ardhmen dhe në TBU, ky investim është i garantuar.



Prof. Dr. Vasilika Kume
Rektore



NGJARJET KRYESORE TË TBU

JANAR - MARS



Më 20 janar, "Cisco Academy" nisi përfshirjen në kurrikulat mësimore të TBU. Përfaqësuesi i "Cisco" Z. Adriano Nuhani, prezantoi strukturën e trajnimeve të nivelit tëlartë, duke përfshirë kurset CCNA (Cisco Certified Network Associate), që trajtojnë koncepte thelbësore si rrjetëzimi, siguria dhe menaxhimi i sistemeve informatike. Ky bashkëpunim, që i përgjigjet kërkesave të tregut modern të punës, do të sjellë përfitime të mëdha për studentët tanë.



Më 5 shkurt nisi Retail Academy në TBU. Qendra e parë e formimit profesional në Shqipëri, e dedikuar ekskluzivisht për sektorin e shitjes me pakicë. Përmes ndërthurjes së trajnimeve me praktikën, teknologjinë inovative dhe ekspertizën e biznesit, Akademia e Retail në TBU po sjell një impakt në rritje në industrinë e shitjes me pakicë në Shqipëri dhe falë sinergjisë së Grupit BALFIN, edhe në rajon.



TBU Tech Academy hapi dyert e saj për studentët. Në nisje, kursi i parë ishte, "Advanced Cybersecurity Techniques", i cili i pajis studentët me njohuri të avancuara në sigurinë kibernetike dhe i përgatit ata për certifikime ndërkombëtare, në tregun global. TBU Tech Academy është vendi ku pasioni për teknologjinë takohet me praktikat më të mira dhe risitë e fundit. Ketu nis një karrierë e sigurt profesionale.



EKSPERTËT E INDUSTRIË TAKOHEN DREJTPËRDREJTË ME STUDENTËT TANË



RENATO CIVILI
CEO - DIGITAL ACADEMY OF ALBANIA

Studentët u njohën me aftësitë kryesore për të arritur sukses në marketingun digjital, duke theksuar rëndësinë e kreativitetit, analizës së të dhënave dhe ndërtimit të një prezence të fortë online.



RAFAELA RICA
THEMELUESE - Iceberg Communication

Studentët përfituan nga njohuritë dhe këshillat praktike për të përmirësuar aftësitë e tyre drejtuese, duke u përgatitur më mirë për sfidat e karrierës së tyre.



RENALDO AGOLLI
Drejtues në Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike

Ky event solli bashkë inovacionin dhe sigurinë, duke nxitur biseda të frytshme mbi të ardhmen e sigurisë kibernetike në Shqipëri.



ARBËR KADIA
CEO DHE BASHKËTHEMELUES I PATOKO

Studentët fituan vlera të rëndësishme në lidhje me përkushtimin, inovacionin dhe rëndësinë e krijimit të zgjidhjeve me vlerë reale për të përmirësuar jetën e njerëzve përmes teknologjisë.



BASHKOHUNI NË VIJIM NË AKTIVITETET TONA

- CEO TALKS
- SFIDA “MATRIX” ME 100 GJIMNAZISTË EKSELENTË NGA GJIMNAZET E TIRANES
- “SAVING GAME” LOJA SIMULUESE E INVESTIMEVE NË BURSË ME 100 MATURANTË GJIMNAZISTË
- KONKURSI #MYFUTUREWITHTBU



 [+355697066966](tel:+355697066966)

 tbu.edu.al

 admissions@tbu.edu.al